



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 31 maj 2021
Nr. Ref.:RK1795/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI53/21

Parashtrues

Limak Kosovo International Airport SH.A. "Adem Jashari"

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 353/2020, të 2 nëntorit 2020

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Shoqëria aksionare Limak Kosovo International Airport SH. A. "Adem Jashari" (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me seli në fshatin Vrellë, komuna e Lipjanit, e cila përfaqësohet me autorizim nga avokati Shkëlzen Sopjani dhe Leonora Fejzullahu.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, [Rev. nr. 353/2020], e 2 nëntorit 2020.
3. Parashtruesi i kërkesës vendimin e kontestuar e ka pranuar më 16 dhjetor 2020.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 mars 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 29 mars 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai (i) plotësimin e formularit; (ii) bashkëngjitjen e përgjigjes në padi, ankesën e revizionin (nëse i ka parashtruar ato) dhe (iii) bashkëngjitjen e vendimeve të Gjykatës Supreme, të cilat i ka listuar si prova por nuk i ka bashkëngjitur. Të njëjtën ditë Gjykata e njoftoi edhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës, dhe dërgoi një shkresë në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan duke e njoftuar lidhur me regjistrimin e rastit si dhe kërkoi nga ajo që të dorëzojë në Gjykatë fletëkthesën që dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar vendimin e kontestuar.
9. Më 31 mars 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, e dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e kërkuar.
10. Më 20 prill 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë (i) formularin e kërkesës; (ii) dy Aktgjykime të Gjykatës Supreme; dhe (iii) përgjigjen në padi.

11. Më 20 maj 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 12 gusht 2010, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe parashtruesi i kërkesës kishin nënshkruar Marrëveshje të Partneritetit Publiko Privat (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja e PPP). Para nënshkrimit të marrëveshjes së PPP-së, Aeroporti i Prishtinës quhej Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (në tekstin e mëtejme: ANP).
13. Në bazë të shkresave të lëndës vërehet se punëtori S.B., kishte qenë i punësuar tek ANP-ja. Punëtori S.B. kishte themeluar marrëdhënie pune me ANP-në më 6 gusht 2009 deri më 3 prill 2011. Bazuar në Marrëveshjen e PPP-së, parashtruesi i kërkesës kishte marrë obligim që të gjithë punëtorët t'i mbajë në marrëdhënie të punës për 3 (tre) vjet. Bazuar në Marrëveshjen e PPP-së, parashtruesi i kërkesës me punëtorin S.B., ka lidhur kontratë pune me kohë të caktuar në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetësh, përkatësisht nga 3 prilli 2011 deri më 3 prill 2014. Në fund, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur edhe një kontratë 1 (një) vjeçare me punëtorin S.B., nga periudha 4 prill 2014 deri 3 prill 2015.
14. Më 3 mars 2015, përkatësisht 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të kontratës me kohë të caktuar, parashtruesi i kërkesës njoftoi punëtorin S.B. se kontrata e tij ka përfunduar përmes një *“Njoftimi për mospërtëritje të kontratës së punës”* dhe arsyetoi se kjo gjë bazohet në *“[...] vendimin e kompanisë për planifikimin e ardhshëm të resurseve njerëzore”*. Nga ana tjetër, si bazë ligjore për mosvazhdimin e kontratës së punës, parashtruesi i kërkesës u bazua në paragrafin 2, të nenit 71 të Ligjit të Punës si dhe kontratën e punës.
15. Në një datë të pacaktuar, punëtori S.B., ka parashtruar ankesë tek parashtruesi i kërkesës *“... me propozim që njoftimi i të paditurës për mospërtëritje të kontratës së punës i dt. 03.03.2015, të anulohet si joligjor dhe paditësin ta kthejë në vendin e mëparshëm të punës, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës”*.
16. Më 19 mars 2015, parashtruesi i kërkesës refuzoi si të pabazuar kërkesën e punëtorit që njoftimin për mosripërtëritje të kontratës ta anulojë si joligjor.
17. Në një datë të paspecifikuar, punëtori S.B. paraqiti kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), ku kërkoi që të anulohet njoftimi i 3 marsit 2015, si dhe përgjigja e parashtruesit të kërkesës e 19 marsit 2015, për mosvazhdimin e kontratës së punës, duke kërkuar që parashtruesi i kërkesës (i padituri) të obligohet që punëtorin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat dhe obligimet, si dhe t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar material.
18. Më 4 maj 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi përgjigjen në padinë e punëtorit S.B., dhe ndër të tjera, kishte theksuar se *“mos-ripërtëritja e kontratës së punës është e bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, të Nenit 71, paragrafi 2, të nenit 67 paragrafi 1.3, si dhe të nenit 1.1 të Kontratës së Punës, andaj në baze të këtyre dispozitave paditësit nuk i është ripërtëritur kontrata e punës”*.

19. Më 12 tetor 2017, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 112/15] refuzoi si të pabazuar, padinë e S.B. dhe duke u thirrur në dispozitën e nenit 71, paragrafi 2 të Ligjit të Punës, dhe nenit 1.1 të kontratës së punës theksoi “[...] *Me rastin e vendosjes në këtë çështje kontestimore gjykata vlerësoi pretendimet e palës paditëse dhe të njëjtat i refuzoi si të pabazuara [...] e paditura ka njoftuar në afatin e përcaktuar paditësin se pas përfundimit respektivisht skadimit të kontratës së punës nuk do t’i vazhdohet kontrata e punës[...]* ”. Prandaj, në rastin konkret, sipas Gjykatës Themelore kontrata e punës ndërpritet sipas fuqisë ligjore me skadimin e kontratës, siç parashihet me nenin 67 paragrafi 1 nënparagrafi 3 i Ligjit të Punës.
20. Në një datë të pacaktuar, punëtori S.B., parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
21. Më 10 mars 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4906/2017] refuzoi, si të pabazuar, ankesën e punëtorit dhe njëkohësisht e vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, duke theksuar se qëndrimin e saj e bazon edhe në nenin 10 paragrafi 2 të Ligjit të Punës, me të cilin është paraparë lidhja e kontratës për kohë të caktuar. Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit, duke mbështetur qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë, iu referua edhe nenit 67 paragrafi 1 pika 3, nenit 71 paragrafi 2 dhe nenit 72 të Ligjit të Punës.
22. Në një datë të pacaktuar, punëtori S.B. parashtrroi revizion kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe shkallës së dytë, ku kërkoi që revizioni i tij të pranohet si i bazuar dhe që të ndryshohen aktgjykimet e dy gjykatave të instancave më të ulëta, në mënyrë që kërkesëpadia e tij të aprovohet si e bazuar dhe parashtruesi i kërkesës të detyrohet t’i kompensojë shpenzimet e procedurës ose të anulohen aktgjykimet e dy gjykatave dhe rasti të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
23. Ndaj këtij revizioni, parashtruesi i kërkesës nuk kishte parashtruar përgjigje.
24. Më 16 tetor 2018, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 353/2020], e aprovoi si të bazuar revizionin e paraqitur nga punëtori S.B. dhe ndryshoi aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit. Me këtë rast, Gjykata Supreme vendosi të (i) aprovojë kërkesëpadinë e punëtorit si të bazuar, (ii) anuloi njoftimin e parashtruesit të kërkesës të 3 marsit 2015, si dhe përgjigjen e parashtruesit të kërkesës të marsit 2015 për mosvazhdimin e kontratës së punës, (iii) obligoi parashtruesin e kërkesës ta kthejë punëtorin në të njëjtin vend të punës, (iv) obligoi parashtruesin e kërkesës t’i paguajë punëtorit një shumë të caktuar në emër të dëmit material, dhe (v) obligoi parashtruesin e kërkesës të mbulojë shpenzimet e procedurës kontestimore.
25. Gjykata Supreme konsideroi se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, kanë zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale ngase nga shkresat e lëndës, përkatësisht me Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, punëtorit S.B., nuk i është vazhduar kontrata e punës në pajtim me Politikën e Bordit të Drejtorëve, Ligjit të Punës dhe vendimit të parashtruesit të kërkesës për Planifikimin e Ardhshëm të

Resurseve Njerëzore. Gjykata Supreme më tej theksoi se “[parashtruesi i kërkesës] ka dështuar për të vërtetuar të gjitha pretendimet e tij lidhur me ligjshmërinë për mosvazhdimin e kontratës [të punësuarit] si dhe vërtetimi i fakteve nëse [parashtruesi i kërkesës] ka përpiluar një plan të detajuar operativ, në të cilin do të përcaktohej se cilat shërbime mund të reduktohen dhe në çfarë përfshirje do të ishin reduktuar, me qëllim të vërtetimit të faktit se provat e parashtruara, paraqesin bazë të vlefshme ligjore për mospërtërirjen e kontratës së punës [...], andaj dështimi i [parashtruesit të kërkesës] në këtë drejtim për mosvazhdimin e kontratës së punës e bën të paligjshëm”.

26. Më tutje, Gjykata Supreme kishte vlerësuar se “objekt i kërkesëpadisë së paditësit nuk është vërtetimi i ekzistimit të marrëdhënies së punës së paditëses në kohë të pacaktuar por vlerësimi i ligjshmërisë së Njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës”, duke konsideruar kështu që gjykatat e instancave më të ulëta e kanë vërtetuar drejtë situatën faktike, por kanë zbatuar gabimisht të drejtën materiale.
27. Gjykata Supreme poashtu gjeti se “pjesa tjetër e kërkesëpadisë paditësit përkitazi me kompensimin e të ardhurave personale është e bazuar në ligj (ne nenin 136 të LMD-së), pasi që largimi nga puna i paditësit vlerësohet si i paligjshëm dhe për këtë arsye paditësit i takon e drejta në kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna[...].”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

28. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme atij i janë shkelur të drejtat edhe liritë e tij siç garantohen me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
29. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj ka shkelur të drejtën e tij për barazi para ligjit dhe gjykim të drejtë dhe të paanshëm sepse ka zbatuar në mënyrë të gabuar të drejtën materiale, për shkak të “zbatimit të njëkohshëm të nenit 67 dhe nenit 70 të LP-se[Ligjit të Punës], kur qartazi është e ditur se nenet në fjale, të ligjit në fjale, zbatohen krejtësisht në rrethana të ndryshme”.
30. Parashtruesi i kërkesës më tej pohon “Qëndrimi i Gjykatës Supreme me Aktgjykimin e kontestuar se i padituri (tani parashtruesi i kërkesës) me rastin e njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës, ka dështuar të vërtetoj plan të detajuar për reduktimin e shërbimeve, është tërësisht i gabueshëm, sepse në këtë rast, nuk aplikohen dispozitat e nenit 70 të LP-se, por dispozitat e nenit 67 të LP-se. Për dijeninë e Gjykatës, neni 70 i LP-se, rregullon ndërprerjen e kontratës së punës në rrethana specifike, dhe ato rrethana janë: a) kur kemi të bëjmë me kontrate të punës me afat të pacaktuar apo rastet me nenin 10, paragrafi 5 të LP dhe b) kur kemi të bëjmë me ndërprerje të kontratës së punës, para skadimit të afatit të saj”.

31. Ndërlidhur me atë më lart, parashtruesi i kërkesës poashtu pohon se sipas tij, *“qartazi kemi të bëjmë me ndërprerjen e kontratës sipas fuqisë ligjore, apo siç; edhe njihet ndryshe mos vazhdimin e kontratës së punës, i rregulluar me nenin 67 paragrafin 1 të LP-se, dhe i ndërlidhur me nenin 1 të Kontratës së Punës, e cila është pranuar dhe nënshkruar me vullnetin e plote të palëve, si dhe në zbatim të nenit 67 paragrafi 3 i LP-se. Andaj, Gjykata Supreme me aktgjykimin e kontestuar, në mënyrë qartazi të gabuar e ka zbatuar të drejtën materiale, dhe si pasojë e kësaj ka dështuar të jap arsyetim të sakte dhe të mjaftueshëm për rastin që është objekt i kësaj kërkesë, dhe njëkohësisht ka shprehur arbitraritet të dukshëm, e me këtë rrjedhimisht, Gjykata Supreme e ka cenuar nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejte dhe të Paanshëm], i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut -E drejta për një proces të rregullt”*.
32. Parashtruesi i kërkesës thekson se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj, ndërhyrë arbitrarisht në vullnetin e palëve dhe me këtë paralelisht cenon parimin e ekonomisë së lirë të tregut.
33. Parashtruesi i kërkesës, duke iu referuar dhe nenit 80 paragrafi 1.2 të Ligjit të Punës, thekson se i njëjti obligon që gjykatat e rregullta ta kthejnë punëtorin në punë nëse ndërprerja ka ndodhur si pasojë e diskriminimit. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme ka detyruar atë të lidhë kontratën e punës me punëtorin me afat të pacaktuar për shkak se vendi i punës është i përhershëm, dhe *“për pasojë gjoja punëdhënësi ka bere shkelje të nenit 5 të LP-se [Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit]”*.
34. Parashtruesi i kërkesës rrjedhimisht thekson se kjo cenon rendë parimin e ekonomisë së lirë të tregut, dhe me këtë vendos praktikë të qartë kundër kushtetuese.
35. Parashtruesi i kërkesës thekson se *“vendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, qartazi krijon standard të dyfishtë juridik në sistemin gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe me këtë cenon rende edhe vet praktiken gjyqësore të Gjykatës Supreme, duke shkaktuar pasiguri juridike në fushën e marrëdhënies së punës. Pra, Gjykata Supreme, si instance me e lartë gjyqësore në vend, e thirrur me ligj (shih paragrafin 1.4 të nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-054 Për Gjykatat, Gazeta Zyrtare Nr. 22, date 18 Dhjetor 2018) që të përcaktoj qëndrime parimore si dhe të nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga të gjitha gjykatat në territorin e Republikës Kosovës, vet krijon praktike të ndryshme juridike dhe me këtë veprim, shkakton pasiguri të rende juridike”*.
36. Parashtruesi i kërkesës, me pretendimin se Gjykata Supreme ka vendosur ndryshe në dy raste të ngjashme i referohet edhe dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme përkatësisht: (i) Aktgjykimit Rev.nr.457/2019 të 30 janarit 2020; dhe (ii) Aktgjykimit Rev.nr.429/2018, të 15 janarit 2019.
37. Rrjedhimisht, për arsye të kontradiktoritetit të vendimeve gjyqësore, parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur edhe neni 119 paragrafi 2 Kapitulli IX Marrëdhëniet Ekonomike, të Kushtetutës. Kjo sepse sipas parashtruesit të kërkesës *“i dekurajon investitorët”* pasi nuk ka siguri juridike.

38. Më tej parashtuesi i kërkesës thekson se është shkelur dhe neni 102 paragrafi 4 i Kushtetutës sepse thekson se *“Shqetësim më i madh për sistemin e drejtësisë sonë dhe për zbatimin e parimit sigurisë juridike, do të ishte në rast se gjyqtari i Supreme B.I, nuk e ka veçuar votën e tij kundër si anëtar i kolegjit, me rastin e vendosjes sipas aktgjykimit të kontestuar të te Gjykatës Supreme Rev.nr.220/2018, i datës 04.07.2018, për shkak se gjyqtari i njëjte ka qene kryetar me rastin e vendosjes, aktgjykimit te Gjykatës Supreme Rev.nr.457/2019, i 02.07.2019.”*
39. Përkitazi me pretendimet për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, për shkak të vendimeve kontradiktore, parashtuesi i kërkesës, citon edhe rastet e Gjykatës ku është gjetur shkelje, përkatësisht, KI04/12 [Aktgjykim i 20 korrikut 2012], e KI89/13 [Aktgjykim i 12 marsit 2014].
40. Lidhur me këtë, parashtuesi i kërkesës thekson se edhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), ka konstatuar se mos konsistenca e vendimeve gjyqësore për çështje të natyrës së ngjashme është në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike (*Beian kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007).
41. Në lidhje me pretendimet për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës i referohet çështjes së kompensimit të pagave dhe përfitimeve të tjera.
42. Parashtuesi i kërkesës, kërkon që Gjykata (i) të deklarojë kërkesën të pranueshme (ii) të konstatojë shkelje të nenit 24 dhe nenit 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (iii) të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, [Rev. nr. 353/2020], të 2 nëntorit 2020 dhe që çështjen ta kthejë në rigjykim.

Dispozitat përkatëse ligjore

Ligji Nr. 03/L-212 i Punës

Neni 5

Ndalimi i të gjitha llojeve të diskriminimit

1. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.

[...]

Neni 10

Kontrata e Punës

[...]

5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Neni 67
[Ndërprerja e Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore]

1. Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet:

[...]

1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;

Neni 70
[Ndërprerja e Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit]

1. Punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur:

1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative;

1.2. i punësuarit nuk është më i aftë t'i kryejë detyrat e punës;

1.3. punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në rrethanat e përcaktuara në nënparagrafin 1, 1 dhe 1, 2 të këtij paragrafi nëse është e papërshtatshme për punëdhënësin që ta transferojë të punësuarin në një vend pune tjetër, ta trajtojë a ta kualifikojë atë për ta kryer punën ose ndonjë punë tjetër;

1.4. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në:

1.4.1. rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe

1.4.2. për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës.

1.5. punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti;

1.6. punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur:

1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një keqsjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve;

1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim.

2. Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nënparagrafit 1.6 të paragrafit 1 të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim.

[...]

Neni 71
[Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës]

1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit:

1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike;

1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzet e pesë (45) ditë kalendarike;

- 1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.
2. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës për kohë të caktuar me njoftim prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike. Punëdhënësi i cili nuk ka për qëllim të ripërtërijë kontratën me periudhë të caktuar duhet të informojë të punësuarin së paku tridhjetë (30) ditë para skadimit të kontratës. Dështimi për ta njoftuar nga punëdhënësi, do t'i japë të drejtën të punësuarit për zgjatjen e tridhjetë (30) ditëve kalendarike shtesë me pagë të plotë.

Neni 80

Vendosja gjyqësore lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës

“1. Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve:

1.1. t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit; ose

1.2. nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthej të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna.

2. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente.”

Marrëveshja e Partneritetit Publiko-Privat për Operim dhe Zgjerim të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës

9.18 [Përfundimi i Personelit]

“Partneri privat mund të përfundoj punësimin ose ndonjë angazhim të çfarëdo punëtori të ANP-së (i) në çdo kohë për çështjet në lidhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuara, (ii) sipas marrëveshjes së përbashkët dhe (iii) pa kufizime, pas përvjetorit të tretë (3) të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

43. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
44. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

45. Gjykata po ashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejné edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme”.*
46. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
47. Në vazhdim, Gjykata vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata së pari u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. *Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
2. *Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. [...]”

48. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e një autoriteti publik, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit, dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
49. Megjithatë, Gjykata i referohet paragrafit (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

50. Gjykata rikujton se kontesti ka filluar si pasojë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së punëtorit S.B. nga ana e parashtruesit të kërkesës. Lidhur me të drejtën për kompensim dhe për kthimin në punë, fillimisht Gjykata Themelore dhe më pas ajo e Apelit, kishin refuzuar si të pabazuara pretendimet e paditësit (personit S.B.), ngase kishin konsideruar se parashtruesi i kërkesës ka njoftuar në afatin e përcaktuar paditësin se pas përfundimit, respektivisht skadimit të kontratës së punës nuk do t'i vazhdohet kontrata e punës. Përfundimet e këtyre gjykatave, pas parashtrimit të revizionit nga ana e personit S.B., nuk i kishte pranuar Gjykata Supreme, e cila në esencë kishte theksuar se objekt i kërkesëpadisë së paditësit nuk është vërtetimi i ekzistimit të marrëdhënies së punës së paditësit në kohë të pacaktuar por vlerësimi i ligjshmërisë së Njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës, dhe me këtë rast kishte konsideruar se parashtruesi i kërkesës nuk e kishte vazhduar kontratën e punës në pajtim me Politikën e Bordit të Drejtorëve, Ligjit të Punës dhe vendimit të parashtruesit të kërkesës për Planifikimin e Ardhshëm të Resurseve Njerëzore.
51. Rrjedhimisht, thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës konsiston në këto çështje si në vijim: (i) pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të aplikimit të gabuar të ligjit (ii) pretendon shkelje të së drejtës së tij për barazi para ligjit, për shkak të jo-konsistencës së vendimeve gjyqësore dhe (iii) shkelje të së drejtës së tij për mbrojtjen e pronës, për shkak të vendimit për kompensimin e pagave dhe të kthimit në punë.
52. Gjykata, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit, do i referohet praktikës gjyqësore të GEDNJ-së, e cila obligon Gjykatën që në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, të interpretojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ-së.

A. Pretendimet rreth zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit të paarsyetuar

(i) *Parimet e përgjithshme përkritazi me aplikimin në e mënyre qartazi të gabuar apo arbitrar të ligjit*

53. Gjykata fillimisht thekson se bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së, parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të "*kushtetutshmërisë*" dhe "*ligjshmërisë*" dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgjyzer Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, "*Adem Jashari*", Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije*

Murtezaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60).

54. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 63).
55. Në këtë kuptim, Gjykata në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka theksuar se edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në aspektin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast specifik e që mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin përkatës (shih rastet e GJEDNJ-së, *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim, paragrafi 83, *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 184/02, paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, nr. 63252/00, paragrafi 98; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], kërkesa nr. 33202/96, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bulgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50; shih gjithashtu, rastin e cituar më lart KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, paragrafi 57; rastet KI154/17 dhe KI05/18, parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, paragrafët 60 deri në 65; si dhe rastin KI121/19, parashtrues *Ipko Telecommunications*, Aktvendim për papranueshmëri i 29 korrikut 2020, paragrafi 58; dhe KI 195/20 parashtrues *Aigars Kesengfelds, pronar i institucionit financiar jo-bankar "Monego"* Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 97).

(ii) *Aplikimi i parimeve të lartcekura në rastin konkret*

56. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës i referohet dispozitave të Ligjit të Punës, përkatësisht faktit që sipas tij, Gjykata Supreme në Aktgjykimin Rev.nr.353/2020 ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, përkatësisht (i) ka zbatuar nenin 67 e 70 të Ligjit të Punës njëkohësisht, edhe pse këto nene zbatohen në rrethana të ndryshme; (ii) arsyetimi i Gjykatës Supreme se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar plan të detajuar për reduktimin e shërbimeve është i gabueshëm, sepse nuk aplikohet në këtë rast neni 70 i Ligjit të Punës por dispozitat e nenit 67, sepse kemi të bëjmë me ndërprerje të kontratës sipas fuqisë ligjore. Lidhur me këto parashtruesi i kërkesës rrjedhimisht pohon se Gjykata Supreme ka dështuar të jap arsyetim të saktë dhe të mjaftueshëm për rastin që është objekt i kësaj kërkesë, dhe njëkohësisht ka shprehur arbitraritet të dukshëm.

57. Gjykata fillimisht rikujton se Gjykata Themelore dhe ajo e Apelit, duke refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e punëtorit S.B. kishin aplikuar nenin 67 paragrafi 1 pika 3, nenin 71 paragrafi 2 dhe nenin 72 të Ligjit të Punës.
58. Pas paraqitjes së revizionit nga ana e personit S.B., Gjykata Supreme kishte ndryshuar Aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta dhe kishte arsyetuar si në vijim:

“Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykatat e instancës ma te ulët gabimisht kane 'aplikuar te drejtën materiale (224.1 te LPK), kur kane gjetur se njoftimi i te paditurit për shkëputjen e kontratës se punës është i ligjshëm, dhe se paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprere ne baze te nenit 67 te Ligjit te Punës, dhe procedurës te përcaktuar me nenin 71 par. 2 te Ligjit te Punës dhe nenit 1.1 te Kontratës se Punës, i cili ishte me kohe te caktuar ne periudhën prej datës 01.05.2011 e deri me datën' 03.04.2015, e qe pas kësaj periudhe nuk barte asnjë obligim ndaj paditësit. Ky përfundim i gjykatës se shkalles se pare është ne kundërshtim me shkresat e lendes pasi që e nga provat që gjinden ne shkresa te lendes, konkretisht Njoftimi i te paditurit me shkrim i datës 03 mars 2015 rezulton se, paditësit nuk i është vazhduar kontrata e punës ne pajtim me politikat e Bordit te Drejtoreve, Ligjit te Punës te Kosovës si dhe vendimit te paditurit për Planifikimin e ardhshëm te resurseve njerëzore, ashtu siç theksohet ne këtë njoftim.

I padituri ka dështuar për të vërtetuar te gjitha pretendimet e tij lidhur me ligjshmërinë e njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës paditësit si dhe vërtetimin e fakteve nëse i padituri ka përpiluar një plan të detajuar operativ, në të cilin do te përcaktohej se cilat shërbime mund të reduktohen dhe në çfarë përfshirje do te duhej te ishin reduktuar, me qëllim të vërtetimit të faktit se provat e parashtruara paraqesin bazë të vlefshme ligjore për mos përtëritjen e kontratës së punës se paditësit, se i padituri ka vepruar në pajtim me vendimin ligjshëm që i plotëson standardet ligjore për mos vazhdimin e kontratës së punës të atyre qe rregullojnë procedurat e shkëputjes se kontratës, andaj dështimi i të paditurit në këtë drejtim, mos vazhdimin e kontratës e bën te paligjshëm.”

59. Gjykata Supreme poashtu kishte theksuar:

“Gjykata Supreme nuk e pranon si te drejtë dhe te ligjshëm qëndrimin juridik e gjykatave te instancës së ulët se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune me kohë të caktuar dhe nuk ka kaluar 10 vite që në kuptim te nenit 10.5 te Ligjit të Punës, marrëdhënia e punës se paditëses të trajtohet me kohë te pacaktuar, për arsye se objekt i kërkesëpadisë se paditësit nuk është vërtetimi i ekzistimit te marrëdhënies se punës se paditëses ne kohe te pacaktuar por vlerësimi i Ligjshmërisë se Njoftimit për mos vazhdimin e kontratës se punës.”

60. Gjykata Supreme, duke iu referuar gjendjes faktike, kishte konstatuar që:

“Paditësi tek paraardhësi i te paditurit ka qene ne marrëdhënie pune, me kohë të caktuar nga data 06.08.2009, e deri në dhënien me koncesion të këtij aeroporti më 2011, e edhe me tutje, kur me kontratën e punës në shkresat e

lëndës, paditësi tek i padituri për të njëjtin vend pune ka lidh marrëdhënie pune për kohë të caktuar filluar nga datat 01.05.2011 gjer me datën 03.04.2015, edhe pse vendi i punës ka qenë i natyrës së përhershme.

Kontratat e tilla sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, janë në kundërshtim me parimin e ndërgjegjeshmërisë dhe ndershmërisë [...] paditësi vazhdimisht mbahet në gjendje të pasigurte [...]. Punëmarrësi nuk mundte heq dorë nga te drejtat e punëtoreve, që rrjedhin nga dispozitat urdhëruese të nenit 5 par.1 të Ligjit të Punës[...] I padituri, ka dështuar për të argumentuar faktin se në rastin e zbatimit të Marrëveshjes së Partneritetit Publiko Privat (PPP) [...] i është përmbajtur ndalimit të diskriminimit, të paraparë me nenin 5.1 të Ligjit të Punës.”

61. Më tej, Gjykata Supreme kishte konkluduar se:

“Sipas njoftimit mbi mosvazhdimin e kontratës së punës del se paditësit kontrata e punës nuk iu është vazhduar nga baza e vendimit të kompanisë për planifikimin e resurseve njerëzore, i cili vendim asnjëherë nga ana e të paditurit nuk i është prezantuar gjykatës dhe as që është prezantuar plani i ardhshëm i resurseve njerëzore, si bazë për vlefshmërinë e njoftimit. [...] I padituri nuk ka respektuar rregullat primare të procedurës dhe detyrimin e tij që gjykatës t’ia prezantojë faktet, mbi të cilat mbështetet pretendimet e veta dhe nuk ka prezantuar prova me të cilat do të kishte provuar bazueshmërinë e pretendimeve të tij, andaj dështimi i të paditurit në këtë drejtim, mos vazhdimin e kontratës së punës së paditësit e bën jo ligjor.”

62. Gjykata bazuar në të lartcekurat, vëren se Gjykata Supreme duke iu referuar gjendjes faktike në rastin konkret, i kishte sqaruar parashtruesit të kërkesës që ai ka dështuar të vërtetojë të gjitha pretendimet e tij lidhur me ligjshmërinë për mosvazhdimin e kontratës së punës si dhe vërtetimin e fakteve relevante, përkatësisht, nëse ai ka përpiluar një plan të detajuar operativ, në të cilin do të përcaktohej se cilat shërbime mund të reduktohen dhe në çfarë përfshirje do të ishin reduktuar, me qëllim të vërtetimit të faktit se provat e parashtruara paraqesin bazë të vlefshme ligjore për mospërtërirjen e kontratës së punës.

63. Gjykata Supreme, për më tepër i kishte sqaruar parashtruesit të kërkesës se (i) njoftimi për mos-vazhdimin e kontratës së punës, nuk është i ligjshëm sepse marrëdhënia e punës ishte ndërprerë bazuar në nenin 67 e 71 të Ligjit të Punës, dhe kjo në kundërshtim me shkresat e lëndës; dhe (ii) objekt i çështjes në rastin në fjalë është vlerësimi i ligjshmërisë së njoftimit për mos vazhdimin e kontratës së punës.

64. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme me Aktgjykimin e saj Rev.nr.353/2020, nuk ka arsyetuar mjaftueshëm. Mirëpo, Gjykata fillimisht kujton që nga shkresat e lëndës, kuptohet që parashtruesi i kërkesës nuk ka parashtruar as përgjigje në revizion. Kjo çështje ndërlidhet me detyrimet e gjykatave të adresojnë pretendimet thelbësore të palëve, e që në rastin konkret, nuk ka qenë e mundur, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk ka parashtruar pretendimet e tij në përgjigjen në revizion.

65. Rrjedhimisht, bazuar në të lartcekurat, Gjykata vlerëson se arsyetimi i Gjykatës Supreme nuk ka rezultuar në konkluzione arbitrare.

66. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak të aplikimit qartazi të gabuar apo arbitrar të ligjit janë të pabazuara në baza kushtetuese siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

B. Pretendimet rreth konsistencës së vendimeve gjyqësore

67. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ngritë dy pretendime kryesore lidhur me këtë pikë, përkatësisht se Gjykata Supreme ka vendosur në (i) dy raste të tjera të ngjashme, ndryshe me rastin pranë nesh dhe (ii) gjyqtari B.I. nuk e ka veçuar votën në rastin *“Rev.nr.220/2018, i datës 04.07.2018, për shkak se gjyqtari i njëjte ka qene kryetar me rastin e vendosjes, aktgjykimit te Gjykatës Supreme Rev.nr.457/2019, i 02.07.2019.”* me ç’rast sipas parashtruesit të kërkesës, është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe neni 24 i Kushtetutës.
68. Lidhur me çështjen e jokonsistencës së vendimeve gjyqësore parashtruesi i kërkesës i ka listuar dy vendime, përkatësisht: (i) Aktgjykimin Rev.nr.457/2019 të 30 janarit 2020; dhe (ii) Aktgjykimin Rev.nr.429/2018, të 15 janarit 2019.
69. Lidhur me Aktgjykimin Rev.nr.457/2019 e 30 janarit 2020, parashtruesi i kërkesës pretendon se:
- a) *“edhe nëse gjykatat në procedurë gjyqësore, vendosin në favor të paditësit (ish- të punësuarit), kthimi i tij ne vendin e punës pas tejkalimit të afateve të kontratës së punës, është i pambështetur në ligj dhe si i tillë i paqëndrueshëm; dhe*
 - b) *e paditura në këto raste ka obligim paditësit t’ia paguaj pagat dhe përfitimet tjera, vetëm deri ne afatin e përcaktuar të kontratës së punës.”*
70. Ndërsa lidhur me Aktgjykimin Rev.nr.429/2018 e 15 janarit 2019 thekson, se në atë rast:
- “paditësit (ish te punësuarit) i takon e drejta në koeficientin e pagës të përcaktuar me kontratën e punës, deri në kohën kur ka qenë në fuqi kjo kontratë e punës dhe pas nënshkrimit kontratës se re, koeficienti i pagës, ndryshon dhe më nuk ka bazë ligjore, të të llogaritet në kompensim, lartësia e koeficientit e parapare me kontratën e mëparshme te punës.”*
71. Gjykata fillimisht thekson se GJEDNJ ka trajtuar jokonsistencën e vendimeve gjyqësore në kuadër të nenit 6 të KEDNJ-së. GJEDNJ ka vendosur tri kriteret themelore, të cilat janë pranuar edhe në praktiken gjyqësore të Gjykatës për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përben shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat përcaktojnë si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime *“të thella dhe afatgjata”* në praktiken gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe në çfarë mase (Në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr. 1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 29 nentorit 2016, paragrafët 116 - 135; *Jordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50;

Nejdet Sahin dhe Perihan Sahin kundër Turqisë, cituar me lart, paragrafi 53; dhe shih rastin e Gjykatës, KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51 dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës të cituar me lart, KI42/17, parashtrues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 39, KI87/17 parashtrues *"IF Skadiforsikring"*, paragrafi 67, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, KI35/18 parashtrues *"Bayerische Versicherungsverband"*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019 paragrafi 70, KI107/19, parashtrues *Gafurr Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, dhe KI45/19, parashtrues *Komuna e Vushtrrisë*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 tetorit 2020, paragrafi 34).

72. Gjykata poashtu në praktikën e saj ka theksuar se parashtruesit e kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktike gjyqësore, duhet t'ia paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre themelore të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e cituar më lart KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 76; dhe rastin KI 45/19, parashtrues *Komuna e Vushtrrisë*, cituar më lart, paragrafi 40).
73. Lidhur me të lartcekurat, Gjykata fillimisht vëren se nga vendimet e bashkëngjitura nga ana e parashtruesit të kërkesës, të paditurit (punëdhënësit) në ato raste janë të ndryshëm. Së dyti, Gjykata vëren se në rastin Rev.nr.457/2019 të 30 janarit 2020, ka të bëjë me ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkaqe disiplinore, ndërsa në rastin, Rev.nr.429/2018, e 15 janarit 2019, ka të bëjë me kompensim të diferencës së pagës.
74. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, përpos një përshtimit të thjeshtë të këtyre Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, nuk ka sqaruar se si kanë ngjashmëri faktike dhe juridike rastet përkatëse me rastin pranë nesh dhe si ka rezultuar kjo në vendime kundërthënëse.
75. Për më tepër, Gjykata thekson se në dritën e praktikës së GJEDNJ-së, kriteri kryesor për të vlerësuar nëse vendimet kundërthënëse janë "dukshëm arbitrare", është "ekzistimi i dallimeve të thella dhe të vazhdueshme", në praktikën gjyqësore përkatëse. Lidhur me këtë Gjykata konstaton se në bazë të dy Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, të nxjerra në 2019 e 2020, e të cilat pretendohet se janë të ngjashme, por nuk vërtetohet ngjashmëria e tyre, nuk është e mundur të kuptohet se ka "dallimeve të thella dhe të vazhdueshme" në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme, e që do të mund të rrezikonte parimin e sigurisë juridike, dhe me këtë, të rezultonte në shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (shih, *mutatis mutandis*, rastet e Gjykatës, KI29/17, *Adem Zhegrova*, cituar me lart, paragrafi 53, dhe *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 44).
76. Së dyti, sa i përket pretendimeve për gjyqtarin B.I. i cili sipas parashtruesit të kërkesës nuk e ka veçuar votën tek "Rev.nr.220/2018, i datës 04.07.2018, për shkak se gjyqtari i njëjti ka qene kryetar me rastin e vendosjes, aktgjykimit te Gjykatës Supreme Rev.nr.457/2019, i 02.07.2019". Gjykata fillimisht, rikujton se

rasti në vendosje pranë nesh është Aktgjykimi Rev.nr. 353/2020 i Gjykatës Supreme, ndërsa Aktgjykimi tjetër i Gjykatës Supreme është Rev.nr. 457/2019 i 30 janarit 2020. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës pranë nesh nuk e ka mbështetur këtë pretendim.

77. Rrjedhimisht Gjykata pretendimin rreth jokonsistencës së vendimeve gjyqësore dhe çështjes së gjyqtarit B.I., i konsideron si pretendime qartazi të pabazuar në baza kushtetuese siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

C. Pretendimet për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

78. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës i referohet çështjes së kompensimit të pagave dhe përfitimeve të tjera që ai duhet t'ia kompensojë personit S.B.
79. Gjykata me këtë rast, thekson se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës. Një qëndrim i tillë mbështetet në praktikën e GJEDNJ-së (shih, *Van der Mussele kundër Belgjikës*, paragrafi 48, Aktgjykimi i GJEDNJ-se, i 23 nëntorit 1983; dhe *Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë*, paragrafi 121, Aktgjykimi i GJEDNJ-se, i 9 tetorit 2003).
80. Parashtruesi i kërkesës mund të pretendojë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për atë që vendimi i kontestuar ka të bëjë me "pronën" e tij. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, "pronë" mund të jetë "pasuria ekzistuese", duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë "pritshmëri legjitime" që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejtë pronësore (shih rastet e Gjykatës KI26/18, parashtruesi i kërkesës "*Jugokoka*" Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2018, paragrafi 49; dhe rastin KI156/18, parashtruesi i kërkesës *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 52).
81. Në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se lind ndonjë "pritje legjitime" atje ku ekziston një kontest në lidhje me interpretimin e drejtë dhe aplikimin e së drejtës së brendshme dhe atje ku parashtruesit e parashtruesit janë hedhur poshtë më pas nga gjykatat kombëtare (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI156/18, parashtruesi i kërkesës *Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 53 dhe shih rastin e GJEDNJ-se *Kopecky kundër Sllovakisë*, Aktgjykimi i 28 shtatorit 2004 paragrafi 50).
82. Për sa më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se Gjykata Supreme përmes Aktgjyqimit [Rev. nr. 353/2020], në bazë të cilit e aprovoi si të bazuar revizionin e paraqitur nga punëtori, duke e obliguar parashtruesin e kërkesës që ta kthejë punëtorin në të njëjtin vend të punës dhe t'ia paguajë punëtorit një shume të caktuar në emër të dëmit material është bërë në mënyrë të paligjshme apo arbitrare. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij pronësore, të garantuara nga neni 46 i Kushtetutës dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, është qartazi i pabazuar mbi baza kushtetuese siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

D. Pretendimet e tjera

83. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendimet e tij për mos konsistencën e vendimeve gjyqësore dhe parimin e sigurisë juridike i ndërlidh me shkeljen e nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe nenit 119 [Parimet e Përgjithshme] tek Kapitulli për Marrëdhënie Ekonomike të Kushtetutës.
84. Argumentet kryesore, për të cilat parashtruesi i kërkesës pretendon (i) shkelje të nenit 102 të Kushtetutës, është fakti se sipas pretendimit, nuk është veçuar vota e gjyqtarit B.I., ndërsa (ii) shkelje të nenit 119 të Kushtetutës sepse sipas tij, pasiguria juridike i dekurajon investitorët.
85. Lidhur me këto, sa i përket shkeljeve të pretenduara të neneve 102 e 119 të Kushtetutës, Gjykata vë në dukje qëndrimin e saj të përgjithshëm se nenet e Kushtetutës të cilat nuk përcaktojnë, drejtpërdrejtë, të drejtat dhe liritë themelore nuk kanë efekt të pavarur. Efekti i tyre vlen vetëm për “gëzimin e të drejtave dhe lirive” që garantohen me dispozitat e Kapitullit II [Të drejtat dhe Liritë Themelore] dhe III [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre] të Kushtetutës (shih, në këtë aspekt, rastet e Gjykatës KI16/19, me parashtrues *Bejta Commerce*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 nëntorit 2019, paragrafi 42; dhe KI67/16, me parashtruese *Lumturije Voca*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 23 janarit 2017, paragrafi 128).
86. Gjykata duke rikujtuar se parashtruesi i kërkesës i ndërlidh këto shkelje me pretendimet si më lart për jokonsistencën e vendimeve gjyqësore, Gjykata tashmë i ka trajtuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me këto, dhe të njëjtat i ka shpallur të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese siç përcaktohet me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës..
87. Në fund, Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesi i kërkesës pranë kësaj Gjykate ka kërkuar edhe vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve të tjera të Gjykatës Supreme. Edhe pse kërkesa pranë nesh, dallon për nga trajtimi i pretendimeve, në thelb kërkesat e parashtruesit të kërkesës pranë kësaj Gjykate ngërthejnë në vetvete konteste të ngjashme me kërkesën pranë nesh. Gjykata në të gjitha kërkesat paraprake ka vendosur se janë të papranueshme, si qartazi të pabazuara mbi baza kushtetuese (shih, posaçërisht, rastet e Gjykatës KI129/18, parashtrues *Limak Kosovo International Airport SHA. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019; KI66/18, parashtrues *Limak Kosovo International Airport SHA. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019; dhe KI36/18, parashtrues *Limak Kosovo International Airport SHA. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 qershorit 2019, KI122/18 parashtrues *Limak Kosovo International Airport SHA. "Adem Jashari"*, Aktvendim për papranueshmëri i 6 nëntorit 2019; KI36/20, parashtrues *Limak Kosovo International Airport SHA. "Adem Jashari"*, Aktvendim për Papranueshmëri i 27 majit 2020).

Përfundim

88. Gjykata konsideron që pretendimet e parashtruesit për shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm për shkak të (i) aplikimit qartazi

të gabuar apo arbitrar të ligjit; dhe (ii) jokonsistencës së vendimeve gjyqësore nga ana e Gjykatës Supreme janë të pabazuara në baza kushtetuese. Gjithashtu, pretendimet për shkeljen e të drejtës së tij për barazi para ligjit dhe të drejtës pronësore, janë të pabazuara në baza kushtetuese.

89. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur dëshmi, fakte dhe argumente që tregojnë se procedurat në gjykatat e rregullta kanë paraqitur në ndonjë mënyrë shkelje kushtetuese të të drejtave të garantuara me Kushtetutë, me të cilat pretendohet se shkelin të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së si dhe me nenin 24, dhe nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
90. Rrjedhimisht, Gjykata vjen në përfundim se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113, paragrafin 7 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 e 47 të Ligjit, rregullat 39 (2) e 59 (2) të Rregullores së punës, më 20 maj 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi